



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I I EKONOMISE FINANCE BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT STRATEGJIK

Nr. 207 prot.



Fushë-Arrëz, më 24. 01. 2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion i Komisionit të Ekonomise Financë Buxhetit Mbiqyrjes Financiare Planifikimit të Zhvillimit Strategjik mbi shqyrtimin e projektvendimit për " Miratimin e shumës së bashkëfinancimit subvencionimit me qira".

Ne zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Rregullores për Funksionimin e Këshillit të Bashkisë, u mbledh Komisioni i Përhershëm i Ekonomise Finances Buxhetit dhe Mbiqyrjes Financiare me anetare : Franc Doda (Kryetar i komisionit), Besjana Marku (Sekretare e Komisionit), Zef Cara (Anetar i Komisionit), Valentin Doci (Anetar i Komisionit), Valentina Lleshaj (Anetare e Komisionit).

Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor, ndërkohë në mbledhjen e komisionit, shpjegimet i dha Përgjegjësi i Finances Z.Dritan Lika ku shpjegoi se: Masa e subvencionit të qirasë me vlerë totale prej **2568450** lekë për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën prej **2053050** lekë, dhe në masën 20% nga Bashkia Fushë-Arrëz në vlerën **515400** lekë.

Lista përfituese është bërë në bazë të VKM Nr. 362 date 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" ku përparësi në subvencionimin e qirasë, sipas VKM nr.384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", kategoritë e përcaktuara në nenet 33 dhe 34/3 të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" si mëposhtë: a)Individët me statusin e jetimit, b) personat me aftësi të kufizuara, c) Të moshuarit, d) Invalidët e punës, Emigrantët e rikthyer, dh) Familjet e policëve të rënë në detyrë, e) Puntori emigrant, ë) Azil-kërkuesit, f) Familjet e komunitetit Rom, g) Familjet e komunitetit Egjiptian, gj) Viktimat e dhunës në familje, h) Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, i) Prindërit e vetëm , që kanë në ngarkim fëmijë, j) Individët, që i përkasin komunitetit LGBTI, k) Të mitur, 14-18 vjeç,dhe të rinj, 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin, l)Vajzat nëna, pas daljes nga programi

banesave sociale të specializuara, II) Familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas Aktit Normativ me Fuqinë e ligjit Nr.3, date 1.3.2012.

Masa e subvencionimit të qirasë për çdo familje është llogaritur sipas pikës 5 të VKM Nr.362 dt.29.5.2019.

Masa e subvencionimit të qirasë është e barabartë si diferencë ndërmjet qirasë reale, që paguan familja, dhe aftësisë paguese së familjes për të përballuar pagimin e qirasë e cila llogaritet për 12 muajt e fundit, Aftësi paguese ,pra qiraje e përballueshme është ajo pjesë e qirasë , të cilën familja/individit arrin ta paguaj me të ardhurat e veta dhe që zë jo më shumë se:

- a) 25% të të ardhurave të një familjeje me të ardhura mesatare ;
- b) 20% të të ardhurave te nje familjeje me të ardhura të ulëta
- c) 15% të të ardhurave të një familjeje me të ardhura shumë të ulëta.

Masa e subvencionit të qirasë me vlerë totale prej **3204000** lekë për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën prej **2563200** lekë, dhe në masën 20% nga Bashkia Fushë-Arrëz në vlerën **640800** lekë.

Anëtarët e komisionit shprehen njëzëri për dakordësinë duke qenë se ky projekt iu vjen në ndihmë familjeve në nevojë, projekt ky i bërë për herë të parë nga ana e zyrtarëve të bashkisë Fushë-Arrëz për komunitetin sipas ligjit në fuqi.

Anëtarët e komisionit, me shumicë votash, kanë dakort me projektin për miratimin e shumës së bashkëfinancimit subvencionimit me qira për vitin 2025 sipas listës emërore të përfituesve të subvencionimit me qira të paraqitur sipas tabelës bashkelidhur me Relacionin dhe kërkuar miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak në mbledhjen plenare të datës 27.01.2025 duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

Sekretare e Komisionit

Besjana Marku



Kryetar i Komisionit

Franc Doda



Valentina Lleshaj
